

Shumë qytetarë europianë vazhdojnë të ekspozohen ndaj ndotjes së dëmshme të ajrit

Ndotja e ajrit përbën rrezikun më të madh të shëndetit mjedisor në Europë. Ajo shkurton jetëgjatësinë e njerëzve dhe kontribuon në sëmundje të rënda të tilla si sëmundjet e zemrës, problemet e frymëmarrjes dhe kancerin. Raporti i ri i publikuar sot nga Agjencia Europiane e Mjedisit (EEA) vlerëson se ndotja e ajrit vazhdon të jetë përgjegjëse për më shumë se 430 000 vdekje të parakohshme në Europë.

Raporti i vitit 2015 për Cilësinë e Ajrit në Europë, përgatitur nga Agjencia Europiane e Mjedisit ('[Air quality in Europe — 2015 report](#)'), shqyrton ekspozimin e popullsisë Europiane ndaj ndotësve të ajrit dhe ofron një pasqyrim të cilësisë së ajrit në baze të të dhënave nga stacionet zyrtare monitoruese në të gjithë Europën (shih tabelën mëposhtë në formatin excel). Ajo tregon se shumica e banorëve të qytetit vazhdojnë të jenë të ekspozuar ndaj ndotësve të ajrit në nivele që konsiderohen të pasigurta nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh).

Ndotësit më problematikë që ndikojnë në shëndetin e njeriut janë grimcat pezull të respirueshme (Particulate matter-PM), ozoni në shtresat e ulëta të atmosferës (O₃) dhe dioksidi i azotit (NO₂). Vlerësimet e ndikimit në shëndet që lidheshin me ekspozimin afatgjatë ndaj grimcave PM_{2.5} treguan se ky ndotës ishte përgjegjës për 432 000 vdekje të parakohshme në Evropë në vitin 2012, nivel ky i ngjashëm me atë të vlerësuar në vitet e mëparshme. Ndikimet e vlerësuara të ekspozimit ndaj NO₂ dhe O₃ ishin rreth 75 000 dhe 17 000 vdekje të parakohshme, respektivisht. Raporti gjithashtu ofron vlerësime të vdekjeve të parakohshme në nivel vendi. (Shih tabelën më poshtë)

‘Pavarësisht përmirësimeve të vazhdueshme në dekadat e fundit, ndotja e ajrit vazhdon të ndikojë në shëndetin e përgjithshëm të qytetarëve Europianë, duke ulur cilësinë e jetës dhe jetëgjatësinë e tyre’; - tha Drejtori Ekzekutiv i EEA-së Z. Hans Bruyninckx. ‘Ajo gjithashtu ka ndikime të konsiderueshme në ekonomi, duke rritur shpenzimet mjekësore dhe duke ulur produktivitetin përmes ditëve të humbura të punës në të gjithë ekonominë’

Krahas shëndetit, ndotësit e ajrit kanë gjithashtu një ndikim të dëmshëm në jetën e bimëve dhe ekosistemet. Këto probleme, duke përfshirë eutrofikimin e shkarkuar nga amoniaku (NH₃) dhe oksidet e azotit (NO_x), si dhe dëmet e shkaktuara nga O₃ tek bimët, janë ende të përhapura në gjithë Europën.

Gjetje të tjera kyçe:

- **Grimcat pezull të respirueshme (PM)** mund të shkaktojnë ose përkeqësojnë sëmundjet kardiovaskulare dhe të mushkrive, ataket në zemer dhe aritmitë. Ato gjithashtu mund të shkaktojnë kancer. Në vitin 2013, 87% e popullsisë urbane në BE ishin të ekspozuar ndaj përqendrimeve të PM_{2.5} që tejkalonin vlerën limit të vendosur nga OBSh-ja për të mbrojtur shëndetin e njeriut. Standarti i cilësisë së ajrit në BE është më pak strikt dhe vetëm 9% e popullsisë ishin të ekspozuar ndaj PM_{2.5} mbi vlerën limit të caktuar nga BE-ja. Përfitimet që rrjedhin nga përmirësimi i cilësisë së ajrit në Europë janë të qarta - përmbyshjen e standartit të OBSh-së për cilësinë e ajrit në të gjithë 28 Shtetet Anëtare të BE-së duke zvogëluar përqëndrimet mesatare të PM_{2.5} me rreth 1/3 dhe duke rezultuar me 144 000 më pak vdekje të parakohshme

krahasuar me situatën e tanishme. Grimcat PM_{2.5} janë grimca me një diametër prej 2.5 µm ose më pak. Grimcat e imëta mund të depërtojnë thellë në mushkri.

- **Ekspozimi ndaj ozonit (O₃)** në qytete vazhdon të mbetet i lartë. Në vitin 2013, 98% e popullsisë urbane e 28 Vendeve Anëtare të BE-së ishin të ekspozuara ndaj përqëndrimit të O₃ mbi vlerën limit të udhëzuar nga OBSH-ja. Rreth 15 % ishin të ekspozuar ndaj përqëndrimeve (më pak strikte) të vlerave limit të BE-së për O₃. Përqëndrimet e ozonit dëmtojnë gjithashtu kulturat bujqësore, pyjet dhe bimët përmes reduktimit të normave të tyre të rritjes dhe rendimenteve. Objektivi afatgjatë për mbrojtjen e vegjetacionit nga O₃ është tejkaluar me 86% të totalit të zonave bujqësore të 28 Vendeve Anëtare të BE-së.
- **Dioksidi i azotit (NO₂)** ndikon drejtpërdrejt në sistemin e frymëmarrjes, por gjithashtu kontribuon në formimin e PM dhe O₃. Në vitin 2013, 9 % e popullsisë urbane të 28 Vendeve Anëtare të BE-së ishin të ekspozuara ndaj përqëndrimeve të NO₂ mbi vlerat limite të OBSH-së dhe standarteve të BE-së, ku 93 % e të gjithë tejkalimeve ndodhin në afërsi të rrugëve.
- **Benzo(a)pyrene (BaP)** është një ndotës organik kancerogjenë. Ekspozimi ndaj ndotjes me BaP është i përhapur, veçanërisht në Europën Qendrore dhe Lindore dhe formohet kryesisht si rezultat i djegies së drurit. Një e katërta e popullsisë urbane të 28 Vendeve Anëtare të BE-së ishin të ekspozuara ndaj përqëndrimeve të BaP mbi vlerat limite në vitin 2013, dhe më shumë se 91 % e saj ishin të ekspozuar ndaj përqëndrimeve të BaP mbi nivelin e vlerësuar referencë, bazuar kjo në shifrat e riskut nga OBSH-ja.
- **Shkarkimet e dioksidit të squfurit (SO₂)** janë ulur ndjeshëm gjatë dekadave të fundit si rezultat i legjislacionit të BE-së, i cili kërkon përdorimin e teknologjive më të mira të mundshme dhe përdorimin e karburanteve me përqëndrim të ulet të squfurit. Aty ishin vetëm disa tejkalime të vogla të vlerave limite të SO₂ në BE për vitin 2013.
- Përqëndrimet në ajër të hapur të monoksidit të karbonit (CO), benzenit dhe metaleve të rënda (arsenik, kadmium, nikel dhe plumb) në vitin 2013 në BE ishin në përgjithësi të ulëta, me pak tejkalime të vlerave limite përkatëse dhe vlerave të synuara të përcaktuara nga legjislacioni i BE-së.

Lidhjet:

[EEA indicator on exceedance of air quality limit values in urban areas](#)

[EEA indicator on exposure of ecosystems to acidification, eutrophication and ozone](#)

EEA [infographic](#) and [video](#) on health impacts of air pollution

European Commission information on [proposed measures to improve Europe's air quality](#)

Vdekjet e parakohshme që i atribuohen ndotjes së ajrit

Vdekjet e parakohshme në vitin 2012 për 40 vende europiane dhe 28 Vendet Anëtare të BE-së, i atribuohen ekspozimit ndaj grimcave të imëta (PM_{2.5}) ozonit (O₃) dhe dioksidit të azotit (NO₂).

Vendi	PM _{2.5}	O ₃	NO ₂
Austria	6 100	320	660
Belgjika	9 300	170	2 300

Bullgaria	14 100	500	700
Kroacia	4 500	270	50
Qipro	790	40	0
Republika Çeke	10 400	380	290
Danimarka	2 900	110	50
Estonia	620	30	0
Finlanda	1 900	60	0
Franca	43 400	1 500	7 700
Gjermania	59 500	2 100	10 400
Greqia	11 100	780	1 300
Hungaria	12 800	610	720
Irlanda	1 200	30	0
Italia	59 500	3 300	21 600
Letonia	1 800	60	90
Lituania	2 300	80	0
Luksenburgu	250	10	60
Malta	200	20	0
Hollanda	10 100	200	2 800
Polonia	44 600	1 100	1 600
Portugalia	5 400	320	470
Rumania	25 500	720	1 500
Slovakia	5 700	250	60
Slovenia	1 700	100	30
Spanja	25 500	1 800	5 900
Suedia	3 700	160	10
Anglia	37 800	530	14 100
Shqiperia	2 200	140	270
Andorra	60	4	0
Bosnja dhe Hercegovina	3 500	200	70
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	3000	130	210
Islanda	100	2	0
Lihtenshtajni	20	1	3

Monako	30	2	7
Mali i Zi	570	40	20
Norvegji	1 700	70	200
San Marino	30	2	0
Serbia ^(a)	13 400	550	1100
Zvicra	4 300	240	950
Totali ^(b)	432 000	17 000	75 000
BE-28 ^(b)	403 000	16 000	72 000

Shënim: ^(a) Përfshirë Kosovën, sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurisë të OKB-së 1244/99.

^(b) 'Totali' dhe shifrat e 'BE-28' janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

Burimi: [Air quality in Europe — 2015 report](#) (Raporti i vitit 2015 për Cilësinë e Ajrit në Europë)